



Prishtinë: 09.02.2017

Kodi i ZRRE-së: V_888_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1548_12_16**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.01.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 09.02.2017, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin T.N. nga Drenasi me shifër të konsumatorit: DPR 90041593 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1547_12_16 i datës 05.12.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 19.01.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i datës 06.07.2015 në vlerë prej 273.85€ është bërë në harmoni me kodin e matjes së OSSH-së neni 4.11.2 dhe mbi këtë bazë KESCO ka ngarkuar konsumatorin për periudhën 12 mujore dhe atë nga periudha 11/2013 deri në periudhën 10.2014, bazuar në procesverbalin e kontrollimit të njehsorit elektrik me numër 1811595 të datës 17.11.2014, rrjedhën e energjisë elektrike për njehsorët me numër 4939877 dhe 63942226 si dhe procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik me numër 0115800 të datës 17.11.2014.

Në ankesën e KESCO theksohet se pasaktësia në matjen e energjisë elektrike nga ana e njehsorit 4939877, KESCO nuk e ka trajtuar si shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike siç përcaktohet me nenin 4.11.3 të Kodit të matjes së OSSH-së. KESCO gjithashtu ka theksuar se procesverbalin me numër 1006184 i datës 07.03.2014, tek i cili bazohet DMK-ja e ZRRE-së për ta bërë korrigjimin vetëm për 8 muaj dhe atë nga periudha 03/2014 deri më 10/2014, nuk është procesverbal në të cilin është testuar matja e njehsorit elektrik por vetëm procesverbal i marrjes së gjendjeve të regjistrimit të energjisë aktive në njehsor me ç'rast edhe është bërë përmirësimi i gjendjeve të njehsorit në CCP me datën 14.04.2014 duke u bazuar në këtë procesverbal, andaj duke marrë për bazë këtë dhe arsyet e theksuara më lartë kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1548_12_16.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Për me tepër Bordi i ka vlerësuar si të bazuara konstatimet e bëra nga shkalla e parë ku vërtetohet se gjendja e evidentuar në procesverbalin e datës 07.03.2014 nuk përputhet me shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në programin e faturimit (ang. Customer Care Package – CCP) dhe atë nga periudha 08/2013, përkatësisht konsumatori është i mbi faturuar në periudhën 09/2013 në tarifën e lartë për **361 kWh** dhe tarifën e ulët për **323 kWh**, e që kjo ka ndodhur si rrjedhojë e faturimit pa matje në periudhën **09/2013**. Gjithashtu edhe nga rrjedha e energjisë konstatohet se gjendja e shpenzimeve në CCP është përmirësuar në periudhën 04/2014, por që nuk është korrigjuar fatura e periudhës 09/2013 e që kjo është në kundërshtim me nenin 23 paragrafin 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*.

Bordi i ZRRE-së sipas ankesës së KESCO-së ka analizuar edhe periudhën e korrigjimit të njehsorit elektrik me ç’rast ka vendosur se KESCO nuk ka arritë të dëshmojë me asnjë provë pretendimin ankimor se DMK, ka aplikuar gabimisht periudhën e korrigjimit për këtë pikë matëse. Bordi po ashtu ka vendosur se periudha e korrigjimit nuk duhet të jetë me e gjatë se shtatë muaj përkatësisht konsumatorit është dashur t’i bëhet korrigjimi për periudhën 03/2014 - 10/2014 duke e marrë për bazë procesverbalin e inspektimit nr. 1006184 të datës 07.03.2014 në të cilin e ekipet e KEDS-it nuk kanë konstatuar se numëruesi i njehsorit nuk punon, si dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0115800 të datës 17.11.2014. Bazuar në këtë, konsumatorit duhet t’i anulohet korrigjimi nr. 75450DPR-90041593 i datës 06.07.2015 në vlerë **273.85€**, kurse duhet të ngarkohet për periudhën 03/2014 deri në periudhën 10/2014 në vlerë **95.68 €**.

Bordi i ZRRE pasi analizoj edhe rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe transaksionet e konsumatorit konstatoi se konsumatori nga fillimi i faturimit e deri në periudhën 06/2013 ka lexim dhe faturim të saktë dhe të rregullt të shpenzimeve mujore, kurse nga periudha 07/2013 deri në periudhën 10/2014 konsumatori është faturuar vetëm me taksa përveç periudhave 09/2013 dhe 05/2014 kur është faturuar pa matje e që kjo ka rezultuar edhe në mos përputhjen e kWh të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 4939877, si dhe në mbi faturimin e konsumatorit e që vërtetohet edhe me procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr. 0115800 të datës 17.11.2014. Për këtë mospërputhje të gjendjes së kWh me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe faturimin pa matje në periudhën 05/2014 është vendosur se kjo faturë duhet të korrigjohet me korrigjimin e kërkuar, kurse fatura e periudhës 09/2013 duhet të anulohet.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se KESCO nuk e ka trajtuar këtë çështje si shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike siç përcaktohet me nenin 4.11.3 të Kodit të matjes së OSSH-së, lidhur me këtë Bordi ka konstatuar se çështja kontestuese nuk ndërlidhet me keqpërdorim të njehsorit elektrik apo pikës matëse por që në rastin konkret kemi të bëjmë me mos-faturim të rregullt të faturave të energjisë elektrike në këtë pikë matëse, andaj pretendimi i KESCO-së në ankesë është i paqëndrueshëm pasi që nuk kemi të bëjmë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 09.02.2017 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit T. N. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.